



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 5 paragrafi 1.3, dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 25.01.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Znj.Dafina Bllaca**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Simir Krasniqi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Dafina Bllaca dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 23.01.2024, Nr.09/1-55-2024, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Simir Krasniqi, i cili ka dhënë deklaratën e dorëheqjes, për arsye të emërimit në pozitën Drejtor për Shëndetësi në komunën e Prizrenit.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është znj.Dafina Bllaca.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë 25.01.2024

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (e), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.5, nenin 6, dhe nenin 9 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 25.01.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.Arber Limani**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Besnik Mujeci.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Arber Limani dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 24.01.2024, Nr.09/01/64/2024, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Besnik Mujeci, për arsye të mungesave seanca të kuvendit të komunës.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është z.Arber Limani.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë 25.01.2024

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 64 paragrafi 2.1 dhe 2.2 si dhe nenin 127 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 25.01.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rregullores Nr.10/2024 Për Shtesat dhe Kompensimet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

- I. Miratohet Rregullorja Nr.10/2024 Për Shtesat dhe Kompensimet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
- II. Rregullorja, si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 25.01.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59 dhe 63 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 25.01.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Pjesëmarrjes së KQZ në Vëzhgimin e Zgjedhjeve Nacionale në Korenë e Jugut

- I. Miratohet pjesëmarrja e KQZ në vëzhgimin e zgjedhjeve nacionale në Korenë e Jugut, nga data 04 -12 prill 2024.
- II. Pjesëmarrës në këtë punëtori janë :
 - 1.Kreshnik Radoniqi
 - 2.Alban Krasniqi
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 25.01.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi